



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN
SEKSIONI CIVIL

Nr. Regj. Them. (13000-00408-13-2025) 194

Nr. vendimit: 194

Data e regjistrimit: 01.04.2025

Data e vendimit: 14.05.2025

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”
(Për fillimin e procedurës së falimentimit)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e përbërë nga:

GJYQTAR: ARDIT KUKA

Asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Erisa Çili, në Elbasan, sot më datë 14.05.2025, në seancë gjyqësore publike, mori në shqyrtim çështjen civile, që i përket:

KËRKUES:

Raiffeisen Bank sh.a., shoqëri aksionare, me seli në Rrugën e Kavajës”, Tiranë, me administrator Z. Alexander Zsolnai, përfaqësuar me autorizim nga Av. Edison Harizaj, i zgjedhur me Prokurën e Posaçe datë 27.03.2025 lëshuar nga Raiffeisen Bank sh..a

OBJEKTI:

Hapjen e procedurave të falimentimit për shoqërinë tregtare “ORTI” sh.p.k., NIPT K62912202U, me seli ne Lagija 28 Nentori, autostrada Elbasan-Metalurgji, Qendra tregtare “Orti”, me administrator Z. Kadri Mehalla.

PALË

PJESËMARRËSE:

- 1. Shoqëria tregtare “ORTI” sh.p.k.**, NIPT K62912202U, me seli ne Lagija 28 Nentori, autostrada Elbasan-Metalurgji, Qendra tregtare “Orti”, përfaqësuar nga administratori Z. Kadri Mehalla dhe Av. Ervis Qytyku, i zgjedhur me deklaram në seancë.
- 2. Znj. Anida Nuri, administratorja e përkohshme mbikëqyrëse** e ORTI sh.p.k., caktuar me Vendimin datë 04.04.2025 të GJSHJP Elbasan

BAZA LIGJORE:

Nenet 13, 14, 15, 17, të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016 “Për falimentimin”. Neni 41, 42, 153 dhe 334 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, pasi administroi provat,

shqyrtoi çështjen në tërësi, si dhe dëgjoi pretendimet e palëve, të cilët kërkuan:
Përfaqësuesi i kreditorit, kërkuessit Raiffeisen Bank sh.a: Hapjen e procedurës së falimentimit. Provohet se shoqëria Orti sh.p.k është në paaftësi paguese dhe aktivet e saj nuk mbulojnë detyrimet. Referuar nenit 16 të Ligjit nr. 110/2016 gjendja e paaftësisë paguese prezumohet në qoftë se kreditori ka dështuar në ekzekutimin e një detyrimi në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar. Gjithashtu administratorja e përkohshme ka rekomanduar hapjen e procedurës së falimentimit.

Administratorja e përkohshme mbikëqyrëse Znj. Anida Nuri: Të çelet procedura e falimentimit. Nga Raporti datë 28.04.2025 rezulton se shoqëria është në paaftësi paguese. Aktiviteti tregtar është mbyllur që në vitin 2018.

Përfaqësuesi i shoqërisë tregtare "ORTI" sh.p.k., administratori Z. Kadri Mëhalla dhe Av. Ervis Qytyku: Rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit. Shoqëria është në gjendje aftësi paguese. Pasuritë e saj dhe konkretisht objekti në pronësi të shoqërisë, ku ushtrohet aktiviteti ka vlerë, që tejkalon detyrimet. Borxhet e shoqërisë janë akumuluar për shkak të një dënimi me gjobë nga administrata tatimore, e cila ka nxjerrë urdhër bllokimi për pasuritë e shoqërisë. Kundravajtja administrative dënimi me gjobë, penalitetet dhe kamatëvonesa janë ankimuar në gjykatën administrative.

VËREN:

I. Rrethanat e faktit

Nga hetimi gjyqësor rezulton se:

Kërkuessi Raiffeisen Bank sh.a është shoqëri aksionare, me objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e veprimtarisë së kredidhënies në të gjitha format e saj, sipas legjislacionit dhe rregulloreve të Bankës së Shqipërisë si institucion financiar bankar . Shoqëria ka selinë në Rrugën e Kavajës", Tiranë dhe është subjekt i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë.

Debitori ORTI sh.p.k., është person juridik, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në datë 11.05.2006, me aktivitet import-eksport, shitje me shumicë dhe pakicë të mallrave dhe artikujve të ndryshëm, industrialë ushqimorë etj., me seli në Bashkinë Elbasan, Lagjja "28 Nëntori", autostrada Elbasan-Metalurgji, Qendra Tregtare ORTI. Ortak i vetëm i saj është Z. Kadri Mëhalla me kuotë 100 % dhe kapital 101,000,000 lekë.

Midis klientëve të shumtë të bankës është shoqëria tregtare ORTI sh.p.k. Rezulton se ndërmjet "Raiffeisen Bank" sh.a. dhe shoqërisë "Orti" sh.p.k. është lidhur Kontrata e Kredisë Nr. 4445 Rep, nr. 2584 Kol, dt. 20.11.2015 me anë të së cilës është dhënë kredi shuma prej 2,100,000 euro. Gjithashtu të njëjtat palë kanë lidhur Kontratën e Kredisë Nr. 4444 Rep, nr. 2583 Kol, dt. 20.11.2015 me anë të së cilës është dhënë kredi shuma prej 1,900,000 euro. Për garantimin e detyrimit sipas kontratave të mësipërme palët kanë lidhur edhe Kontratën e Hipotekës Nr. 4446 Rep, nr. 2585 Kol, dt. 20.11.2015 me ane të së cilës është rënduar me hipotekë, ndër të tjera pasuria e paluajtshme "truall dhe ndertese", Nr. 9/366, ZK 8523, vol. 32, fq. 22, me sipërfaqe 3000 m2, nga te cilat 1,346 m2 ndërtesë, me adresë në Elbasan.

Kredimarrësi nuk ka qenë i rregullt me shlyerjen e kredisë dhe për këtë shkak banka i është drejtuar gjykatës duke kërkuar lëshimin e urdherit të ekzekutimit. Kërkesat e bankës janë pranuar. Me Vendimin nr. 631, datë 27.06.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për Kontratën e Kredisë Nr. 4444 Rep, nr. 2583 Kol, dt. 20.11.2015 dhe me Vendimin

nr. 632, datë 23.06.2017 ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për Kontratën e Kredisë Nr. 4445 Rep, nr. 2584 Kol, dt. 20.11.2015.

Kreditori ka ndërmarrë hapa të mëtejshëm për ekzekutimin e detyrimit. Në datën 13.12.2017 kreditori ka paraqitur kërkesë në Zyrën Përmbartimore “Kodra Bailiff Service” sh.p.k. për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 632 Akti, date 23.06.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan ne ngarkim të kredimarrësit shoqërisë “Orti” sh.p.k.

Nga ana shoqërisë përmbartimore janë ndërmarrë veprimet përmbartimore, por nuk ka mundur të vërë në ekzekutim titullin ekzekutiv, pasurinë e vënë si garanci me kontratën e hipotekës, pasurinë e paluajtshme të llojit “truall + ndërtesë”, Nr. 9/366, ZK 8523, vol 32, fq. 22, me sipërfaqe 3000 m², nga te cilat 1,346 m² me adrese ne Elbasan) ankandeve, sepse mbi këtë pronë është vënë barrë hipotekore nga organet tatimore. Me Shkresën nr. 1926/7-0775-17 Prot., datë 26.12.2017 Zyra Përmbartimore “Kodra Bailiff Service” sh.p.k., ka njoftuar debitorin për përmbushjen vullnetare të detyrimit, duke e paralajmëruar se në të kundër do të vijohet me ekzekutimin e detyrueshëm. Me Urdhrin nr. 122/7-0775-17 Prot., datë 19.09.2024 Zyra Përmbartimore “Kodra Bailiff Service” sh.p.k ka urdhëruar vënien në sekuestro konservative të llogarive rrjedhëse, depozitave dhe kredive të ORTI sh.p.k dhe dorëzanësit Kadri Mëhalla. Me Shkresat respektive bankat e nivelit të dytë Fibank, OTP Bank, UBA Bank, Pro Credit Bank etj., kanë njoftuar se balancat në llogari janë negative.

Me Vendimin nr. 1890/4-0775-17 Prot., datë 20.12.2018 Zyra Përmbartimore “Kodra Bailiff Service” sh.p.k kakaluar në pronësi të kreditorit Raiffeisen Bank sh.a. pas ankandit të tretë të zhvilluar pasurinë nr. 2/649, Z 8524, me sip. 300 m², ndërtesë 160.9 m², e ndodhur në Lagjen “Partizani”, Bashkia Elbasan.

Përmbartuesi gjyqesor është në pamundësi për të ekzekutuar pasuritë e paluajtshme në pronësi të hipotekuesve për shkak të barrës hipotekore nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tirane. Banka pas kaq shume kohesh eshte ne pamundesi per shlyerjen e detyrimit per shkak te barres tatimore te vendosur nga institucioni i cili nuk kryen asnje veprim ligjor me kete barre dhe pronës.

Me Shkresën datë 20.03.2025 Banka Raiffeisen sh.a ka konfirmuar se detyrimet ndaj bankkës nga shoqëria tregtare “ORTI” sh.p.k. janë në shumën 1,872,321 euro dhe 273,751,067.91 lekë dhe 11,036,247.04 Leke tarifa dhe shpenzime përmbartimore.

Rezulton se me aktin administrativ Njoftim vlerësimi për detyrimet nr. 17066/7, datë 30.08.2017 është vlerësuar se detyrimet tatimore janë në vlerën 92,315,568 lekë. Akti administrativ është ankimuar në gjykatën administrative. Me Vendimin nr. 777, datë 20.03.2024 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka rrëzuar padinë në çështjen civile me palë paditës ORTI sh.p.k., të padituri Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Drejtoria e Apelitit Tatimor dhe objekt “Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të njoftim vlerësimit për detyrimet nr. 17066/7, datë 30.08.2017 të nxjerrë nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë dhe Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 4, datë 14.11.2017 të Drejtorisë së Apelitit Tatimor. Ky vendim është ankimuar me Shkresën datë 21.03.2025 nga përfaqësuesi i paditësit në Gjykatën Administrative të Apelit dhe çështja është në pritje për shqyrtim.

Mbështetur në nenin 16 të Ligjit nr. 110/2016 “Per Falimentimin” kreditori i është drejtuar GJSHPJP Elbasan me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit dhe emërimin e një eksperti kontabël që të veprojë si administrator i përkohshëm i debitorit, të cilit t’i ngarkohen këto detyra: “a) te verifikoje ekzistencën e shkaqeve për të filluar procedurën e falimentimit, b) te

verifikoje nese pasurite e debitorit mund te mbulojne kostot e procedurave te falimentimit, c) te mbikeqyre veprimtarite e debitorit (nese ka). Sipas kreditorit, pasuria e shoqërisë për të cilën kerkohet hapja e procedurave te falimentimit mjafton për perballimin e shpenzimeve te falimentimit pasi shoqëria ka në pronësi te saj pasurine e paluajtshme te përshkruar me siper.

Në zbatim të neneve 14, 18/2, 19, 21 dhe 29 të Me Shkresën datë 04.04.2025 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan njoftoi debitorin ORTI sh.p.k për të drejtën për të kundërshtuar me shkrim hapjen e procedurës së falimentimit brenda 10 ditëve, si dhe duke i bërë të ditur detyrimin për të depozituar dokumentet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, të tilla si raportin e debitorit, ekstraktin historik nga QKB, bilancin dhe pasqyrat financiare të tre viteve të fundit, listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, listën e kreditorëve persona fizikë e juridikë, listën e debitorëve persona fizikë e juridikë etj.

Me Shkresën datë prot. 14.04.2015 administratori i shoqërisë ORTI sh.p.k. ka përcjellë informacion mbi gjendjen e shoqërisë. Në këtë shkresë sqarohet se aktiviteti i shoqërisë është mbyllur që prej vitit 2018. Ndaj shoqërisë është marrë masë administrative nga organet tatimore si gjobë dhe kamatëvonesa, të cilat janë kundërshtuar në gjykatën administrative. Nuk ka një listë specifike të debitorëve, por ka bashkëlidhur disa vendime gjyqësore, urdhra ekzekutimi me debitor këtë shoqëri. Gjithashtu, gjatë seancës gjyqësore depozitoi disa njoftime detyrimesh të DRT Elbasan.

Administratori i shoqërisë Z. Kadri Mëhalla ka sjellë 65 vendime gjyqësore (pas depozitimit të raportit nga administratorja e përkohshme) të komunikuar me Shkresën nr. 8204 Prot., datë 14.04.2025 të Kancelarisë së GJSHPJP Elbasan, që sipas tij janë detyrime të papërmbyshura nga shoqëria në vite. Nga këto rezultojnë se përmbajnë detyrime vendimet sipas listës në vijim:

1. *Vendim nr. 755, datë 16.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Lara Dairy" sh.p.k, me administrator Z. Ledio Braho, me seli në Tiranë, Qendër Kashar, Njësia Administrative Kashar, Fabrika e Qumështit, me detyrime me vlerë respektivisht 129,360, 61,380, 28,840, 33,990, 32,760, 61,380 lekë.*
2. *Vendim nr. 5, datë 16.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Dilo" sh.p.k, me seli në Qafë-Shtamë, Bashkia Durrës, me vlerë detyrimi 340,746 lekë dhe 20,000 lekë.*
3. *Vendim nr. 7, datë 13.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Gema Distribution" sh.p.k, me seli në Bashkinë Tiranë, Njësia Administrative Kashar, Mëzes, Rr. "Demneri", Nd. 19, prapa Vodafone sh.a, me vlerë detyrimi 4,760,105 lekë*
4. *Vendim nr. 45, datë 24.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Euro Trade Albania" sh.p.k, me administrator Z. Ledio Braho, me seli në Tiranë, Rr. "Frederik Shiroka, Kulla 3, Shk. 3, kt. 2, Nr. 2, me vlerë detyrimi 474,260 lekë.*
5. *Vendim nr. 46, datë 20.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Euro Trade Albania" sh.p.k, me administrator Z. Ledio Braho, me seli në Tiranë, Rr. "Frederik Shiroka, Kulla 3, Shk. 3, kt. 2, Nr. 2, me vlerë detyrimi 399,526 lekë.*
6. *Vendim nr. 47, datë 18.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim*

- urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Euro Trade Albania" sh.p.k*, me administrator Z. Ledio Braho, me se në Tiranë, Rr. "Frederik Shiroka, Kulla 3, Shk. 3, kt. 2, Nr. 2.
7. *Vendim nr. 48, datë 26.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Albanian Distribution Development" sh.p.k*, me seli në Bashkinë Tiranë, Kashar, Rr. "Dhaskal Todri" Nr. 35, me vlerë detyrimi 4,083,704 lekë.
 8. *Vendim nr. 90, datë 07.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Harri Lena" sh.p.k*, me seli në Bashkinë Tiranë, Njësia Administrative Kashar, Km 2, pranë HL Group, me vlerë detyrimi 218,880 lekë dhe 2,599,718 lekë.
 9. *Vendim nr. 92, datë 08.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Sea Salt Albania" sh.p.k*, me vlerë detyrimi 375,600 lekë.
 10. *Vendim nr. 235, datë 17.03.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "ABC Group" sh.p.k*, me seli në Bashkinë Tiranë, Njësia Administrative Nr. 11, Rr. "Gjergj Legisi", ish- Pularia përballë magazinave "Adidas", me vlerë detyrimi 116,430 lekë.
 11. *Vendim nr. 265, datë 15.03.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "FENIS" sh.p.k*, me administrator Z. Ndrec Kola, me vlerë detyrimi 319,596.2 lekë.
 12. *Vendim nr. 78, datë 15.03.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *person fizik Alban Lika*, me vlerë detyrimi 141,230 lekë, 63,500 lekë, 530,080 lekë, 58,000 lekë, 21,080 lekë, 21,080 lek, 62,640 lekë, 59,040 lekë, 22,000 lekë, 58,000 lekë, 47,240 lekë, 108,000 lekë, 266,360 lekë, 17,880 lekë, 86,614 lekë, 40,400 lekë, 46,880 lekë, 34,960 lekë, 16,280 lekë, 125,000 lekë, 70,410 lekë, 3,170 lekë, 87,920 lekë, 54, 160 lekë, 62,440 lekë, 293,340 lekë, 124,860 lekë dhe 97,920 lekë.
 13. *Vendim nr. 363, datë 29.03.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Manilla" sh.p.k*, me seli në Bashkinë Vlorë, fshati Babicë e Madhe, RR. "Vlorë-Babicë". Km 4, Tuneli, me vlerë detyrimi 109,200 lekë.
 14. *Vendim nr. 430, datë 28.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Eugen Skremo" sh.p.k*, me seli në fshatin Plasë, Çezma e Bardhë, Bashkia Korçë, ferma e Bletëve "Morava".
 15. *Vendim nr. 435, datë 28.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "German Brands" sh.p.k*, me seli në Bashkinë Tiranë, Rr. "Tish Daia", 1060..
 16. *Vendim nr. 429, datë 04.05.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "SE& AN" sh.p.k*, me seli në Bashkinë Durrës, autostrada Durrës- Tiranë, Km 3, Kompleksi i Magazinave "Euro Business 2006", me administrator Z. Selaudin Sulejmani, me vlerë detyrimi respektivisht 1,162,650 lekë, 1, 162,150 lekë, 1, 422,100 lek, 2,304,000 lekë, 1, 432, 646 lekë, 938,272 lekë dhe 1,720,152 lekë.

17. *Vendim nr. 489, datë 12.05.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "BBI Group" sh.p.k, me administrator Z. Ergys Gashi, me seli në Bashkinë Vorë, fshati Muçaj, përballë Servis "KIA Vorë", me vlerë detyrimi respektivisht 60,000 lekë, 35,200 lekë dhe 61,200 lekë.*
18. *Vendim nr. 530, datë 25.05.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Brand Distribution" sh.p.k, me administrator Z. Bashkim Sheme, me vlerë detyrimi 324,414 lekë.*
19. *Vendim nr. 575, datë 08.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Çini 2009" sh.p.k, me administrator Z. Bashkim Sheme, me seli në Gjirokastrë, me vlerë detyrimi 46,549 lekë.*
20. *Vendim nr. 577, datë 02.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Çini 2009" sh.p.k, me administrator Z. Bashkim Sheme, me seli në Gjirokastrë, me vlerë detyrimi 24,990 lekë.*
21. *Vendim nr. 586, datë 09.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "KJENDY" sh.p.k, me administrator Z. Bashkim Sheme, me seli në Tiranë, Rr. "Myslym Shyri", Kulla 1, H. 1, Ap. 1, me vlerë detyrimi 301,513 lekë.*
22. *Vendim nr. 631, datë 27.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Raiffeisen Bank" sh.p.k, , me vlerë detyrimi 273,751,067.091 lekë.*
23. *Vendim nr. 642, datë 05.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Llabunishti" sh.p.k, me administrator Z. Arjan Ali, me seli në Bashkinë Korçë, Rr. "Papa Llambro Ballamaci".*
24. *Vendim nr. 726, datë 26.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "HARJA" sh.p.k, me seli në Bashkinë Elbasan, Lagjja "28 Nëntori", ish Fabrika e Vajit.*
25. *Vendim nr. 739, datë 12.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "EHË" sh.p.k, me seli në Bashkinë Tiranë, Rr. "Tiranë-Durrës", Km 4. 8, me vlerë detyrimi respektivisht 44,689.45 lekë, 79,060.44 lekë, 52,856.2 lekë, 37,650.9 lekë, 45,967.9 lekë, 79,060.44 lekë, 214,438.5 lekë, 128,598.2 lekë dhe 143,051.3 lekë*
26. *Vendim nr. 760, datë 20.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Micro Credit Albania" sh.p.k, me seli në Bashkinë Tiranë, Qendra e Biznesit Star, Rr. "Maliq Gjoka", me vlerë detyrimi 30,421.94 lekë.*
27. *Vendim nr. 807, datë 02.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "Bloja" sh.a, me seli në Bashkinë Tiranë, Rr. "Konferenca e Pezës", Fabrika e Miellit "Bloja", me vlerë detyrimi 174,000 lekë.*
28. *Vendim nr. 900, datë 18.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor shoqëria tregtare "PRIMA" sh.p.k, me seli në Bashkinë Tiranë, Rr. "Konferenca e Pezës", ish Fabrika e Mielli, me vlerë detyrimi respektivisht 1,719,000, 1,400,481 dhe 1,149,634 lekë*
29. *Vendim nr. 930, datë 27.1.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt lëshim*

- urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Pasticeri Lika" sh.p.k.*, me seli në Bashkinë Tiranë, Rr. "Vasfi Samini", ish SMT, Magazinë nr. 1, me vlerë detyrimi respektivisht 392,018 lekë, 36,290 lekë, 48,839.50 lekë, 3,087.50 lekë, 21,009.25 lekë, 19,427.5 lekë, 11,751.50 lekë, 64,847 lekë dhe 11,153 lekë.
30. *Vendim nr. 1, datë 10.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *Agjencia Kolektive e Mbrojtjes së të Drejtave Kolektive* me seli në Bashkinë Tiranë, Rr. "Andon Zako Çajupi", me vlerë detyrimi 21,040 lekë dhe 15,840 lekë.
31. *Vendim nr. 281, datë 14.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Abdurramani" sh.p.k* me seli në fshatin Mbrostar, Bashkia Fier, me vlerë detyrimi 671,680 dhe 12,000 lekë.
32. *Vendim nr. 352, datë 25.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Banca Credins" sh.a* me seli në Bashkinë Tiranë Rr. "Vaso Pasha", Nd. 8, me vlerë detyrimi 35,150,046 lekë.
33. *Vendim nr. 686, datë 09.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Tona Co" sh.p.k.*, me seli në Bashkinë Korçë, Zona Industriale në hyrje të qytetit me vlerë detyrimi 662,162 lekë.
34. *Vendim nr. 93, datë 27.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Klimart Albania" sh.p.k.*, me administrator Z. Maria Nikoletopou, me se në Tiranë, Rr. "Teodor Keko", pranë ALPHA Bank, Unaza e Re, me vlerë detyrimi 14,508 euro, 5439.6 euro, 31,166 euro.
35. *Vendim nr. 190, datë 10.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Erzeni" sh.p.k.*, me seli në Bashkinë Berat, fshati Samaticë, lagjja "Qendër", me vlerë detyrimi 1,377,080 lekë.
36. *Vendim nr. 439, datë 21.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Orbico" sh.p.k.*, me administrator Znj. Arlinda Marku, me seli në Bashkinë Tiranë, autostrada Tiranë-Durrës, Km 1, me vlerë detyrimi 1,655,134.76 lekë.
37. *Vendim nr. 439, datë 21.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Alpha Security" sh.p.k.*, me seli në Bashkinë Elbasan, Lagjja "Sul Papri", me vlerë detyrimi 660,000 lekë.
38. *Vendim nr. 1208, datë 31.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Alpha Security" sh.p.k.*, me seli në Bashkinë Elbasan, Lagjja "Sul Papri".
39. *Vendim nr. 266, datë 29.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, kreditor *shoqëria tregtare "Banka e Parë e Investimeve" sh.a.*, me seli në Bashkinë Tiranë, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, me vlerë detyrimi 39,054,547 si bashkëkredimarrës.
40. *Vendim penal i formës së prerë nr. 721, datë 02.11.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan* me të cilin është dënuar me gjobë në masën 334,000 lekë shoqëria tregtare ORTI sh.p.k., për veprën penale të "Fshehjes së të ardhurave", të parashikuar nga neni 180/3 i Kodit Penal, me kreditor Prokuroria pranë GJSHPJP Elbasan.

Me Shkresën nr. 311, datë 07.04.2025 OSHEE Elbasan sh.a., ka përcjellë detajet e e pagesës për Orti sh.p.k -Kadri Mëhalla dhe rezultojnë detyrime të papaguara si në vijim:

- (i) Per kontraten me kod EL0A260088180028 debia 1,927,349.50 principal+kamate
- (ii) Per kontraten me kod EL0A260001245624 debia 14,284,265.63 principal+kamate
- (iii) Per kontraten me kod EL0A260131241727 debia qe i takon FShu.sha eshte ne vleren 28,816,872.02 periudha maj 2015-dhjetor 2023 pjesa e mbetur e debise shkon per FTL sha.

Me Shkresën nr. 2173/1, datë 08.04.2025 DRT Elbasan ka përcjellë detyrimet e prapambetura të subjektit ORTI sh.p.k deri më këtë datë të përbëra nga:

- (i) Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore 34,154,971 (Tridhjetëekatër milionenjëqindpesëdhjetëkatërmijëenëntëqindeshatatëdhjetënjë) Lekë
- (ii) Tatim i Mbajtur ne Burim 4,732,414 (Katër milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë katërqind e katërbëdhjetë) Lekë
- (iii) Tatim mbi Vlerën e Shtuar 22,026,100 (Njzetë e dymilion e njzetë e gjashtëmijë e një qind) Lekë

(iv) Gjoha 1,210,000 (Njëmilionedyqindedhjetëmijë) Lekë

(v) Tatim mbi Fitimin 169,037,111 (Njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e tridhjetë e shtatë mijë e njeqind e njëmbëdhjetë) Lekë

Subjekti ka detyrime/ gjobë te papaguara shumen 231,151,596 (Dyqind e tridhjetë e një milion e qinde pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Lekë. Subjekti eshte ne status pasiv prej dates 26.02.2019.

Me qëllim për të mbrojtur interesat e kreditorëve dhe mirëadministrimin e shoqërisë, me GJSHJPJ Elbasan caktoi si administratore të përkohshme mbikëqyrëse Znj. Anida Nuri. Me Vendimin nr. 194, datë 04.04.2025 GJSHJPJ Elbasan ka vendosur: “ 1. Pranimin e kërkesës së kreditorit “Banka Raiffeisen” sh.a, për marrjen e masës së përkohshme ndaj debitorit “ORTI” sh.p.k., me administrator Z. Kadri Mëhalla, dhe seli në adresën: Bashkia Elbasan, , Lagjja 28 Nëntori”, autostrada Elbasan-Metalurgji, Qendra Tregtare Orti, për caktimin e administratorit të përkohshëm mbikëqyrës dhe marrjen e masave të përkohshme përpara fillimit të procedurës së falimentimit. 2. Caktimin e administratorit të përkohshëm mbikëqyrës Znj. Anida Nuri me adresë, Bashkia Tiranë, Rr “ Babe Rexha”, P.10/1, Shk.2 Ap 27, T, Cel +355694059730 për të mbikëqyrur shoqërinë tregtare ORTI sh.p.k, me NIPT K62912202U për administrimin e pasurive të saj të luajtshme dhe të paluajtshme. 3. Urdhërohet ndalimi i debitorit ORTI sh.p.k për të disponuar pasurinë në çdo mënyrë që është jashtë veprimtarisë normale të aktivitetit. 4. Administratorit të përkohshëm mbikëqyrës Znj. Anida Nuri ngarkohet me këto detyra: a. Të kontrollojë veprimet e debitorit dhe të raportojë masa të mëtejshme, të cilat mund të konsiderohen të nevojshme për administratorin e falimentimit. b. Të japë mendim me shkrim nëse është e nevojshme fillimi i procedurës së falimentimi, që përfshin: i) për të verifikuar nëse ekzistojnë shkaqe për të filluar procedurën e falimentimit; ii) për të verifikuar nëse pasuritë e debitorit mund të mbulojnë kostot e procedurave të falimentimit; iii) për të mbikëqyrur veprimtaritë e debitorit; iv) për të dhënë një opinion nëse është e nevojshme të vendosen masa të përkohshme për të siguruar pasuritë. 5. Administratori i përkohshëm ka të drejtë të hyjë dhe të hetojë në mjediset e debitorit. 6. Debitori duhet të lejojë administratorin e përkohshëm që të kontrollojë librat dhe shënimet e tij dhe t'i vendosë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm. 7. Shpërblimi për veprimtarinë si administrator i përkohshëm i falimentimit në shumën 100,000 (njëqind mijë) lekë i ngarkohet

debitorit. 8. Këto masa janë me efekt 30 (tridhjetë) ditë nga data e dhënies së vendimit dhe humbasin efektet pas kalimit të këtij afati. 9. Një kopje e këtij vendimi, t'i njoftohet debitorit shoqërisë tregtare "ORTI" sh.p.k., që ngarkohen me afishimin e tij në adresën e internetit, nëse ka të tillë. 10. Një kopje e këtij vendimi, t'i njoftohet administratores së përkohshme mbikëqyrëse Znj. Anida Nuri. 11. Një kopje e këtij vendimi të shpallet publikisht në këndin e njoftimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe në adresën e internetit të kësaj gjykate. 12. Një kopje e këtij vendimi të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në të gjitha autoritet publike, që sipas rastit, kërkohen nga ligji për të pasqyruar shënimet përkatëse. 13. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Agjencisë Kombëtare të Falimentimit. 14. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe është menjëherë i ekzekutueshëm. 15. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të arsyetuar".

Ndër të tjera në këtë vendim administratores së përkohshme mbikëqyrëse iu ngarkua si detyrë që të japë mendim me shkrim nëse është e nevojshme fillimi i procedurës së falimentimit, që përfshin këto çështje: i) për të verifikuar nëse ekzistojnë shkaqe për të filluar procedurën e falimentimit; ii) për të verifikuar nëse pasuritë e debitorit mund të mbulojnë kostot e procedurave të falimentimit; iii) për të mbikëqyrur veprimtaritë e debitorit; iv) për të dhënë një opinion nëse është e nevojshme të vendosen masa të përkohshme për të siguruar pasuritë

Me *Raportin e Administratorit të Përkohshëm të Falimentimit datë 28.04.2025*, administratorja e përkohshme Znj. Anida Nuri ka referuar:

I. Lidhur me shkaqet për fillimin e procedurës së falimentimit. Sipas Vërtetimit datë 08.04.2025 të DRT Elbasan, shoqëria është në status pasiv që nga data 26.02.2019, pra nuk ka ushtruar aktivitet tregtar sipas ligjit, që nga ajo date. Në ekstraktin historik të shoqërisë, që prej vitit 2016 e deri në 05.10.2023 ka shumë urdhra permbarimore për sekuestro të pasurive të Orti shpk, nga kreditorët e tij. Në vazhdim nuk ka heqje të urdhrave permbarimore, përveç pak rasteve, që tregojnë shlyerjen e detyrimeve të kreditorëve, qofshin këta furnitorë, banka, organet tatimore etj.

Detyrimet tatimore të shoqërisë ORTI shpk. Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, DRTE ka konfirmuar me datë 8.04.2025 se shoqëria ka detyrime si më poshtë:

34,154,971 leke për detyrime për sigurimet shoqërore e shëndetësore

22,026,100 leke detyrime për TVSH

174,970,525 leke për tatim fitimi, gjoha e interesa, etj

Total 231,151,596 leke sipas sistemit informatik tatimor

Detyrimet për hua të shoqërisë ORTI shpk. Shoqëria ORTI shpk ka lidhur dy kontrata kredie me Raiffeisen Bank shpka përkatësisht "Kontrate kredie me kufi nr 4444 dt 20.11.2015 ndërmjet Raiffeisen Bank shpka dhe Orti shpk; Kontrate kredie bankare nr 4445 dt 20.11.2015 ndërmjet Raiffeisen Bank shpka dhe Orti shpk. Shumat e kredive janë 2,100,000 Euro dhe 1,900,000 Euro. Këto kredi nuk janë shlyer rregullisht dhe Raiffeisen Bank ka filluar procedurat permbarimore nëpërmjet vendimeve:

-Vendim gjykate për leshim urdher ekzekutimi nr 631 dt 27.06.2017 për shumën 273,751,067.91 Leke, që përfshin principalin e kredise, interesat dhe penalitetet

Vendim gjykate për leshim urdher ekzekutimi nr 632 dt 23.06.2017 për shumën 2,001,849 Euro, që përfshin principalin e kredise, interesat dhe kamatat.

Permbareuesi Kodra Bailiff Service ka leshuar dokumentin Lajmerim Ekzekutimi Vullnetar dt 26.02.2017, per shoqerine ORTI shpk, dhe me pas ka leshuar Urdher per vendosjen e sekuestros konservative dt 19.09.2024, per kreditorin Raiffeisen Bank.

Ne dosjen gjyqesore nuk ka dokumentacion qe keto kredi te jene shlyer.
-Raiffeisen Bank sha ka siguruar huate nepermjet kolateralit pasuri e paluajtshme me nr 9/366 (truall 3000m2 dhe ndertese 1326m2), ne pronesi te ORTI shpk dhe ka ndermarre procedurat ligjore per ekzekutimin e tyre nepermjet sherbimit permbarimor, procedura te cilat nuk jane perfunduar aktualisht, dhe huate nuk jane shlyer ende nga shoqeria ORTI shpk.

Si konkluzion, shoqeria ORTI shpk nuk ka shlyer te gjitha detyrimet e saj ne daten e maturimit, kundrejt kreditoreve te ndryshem si Raiffeisen Bank, DPT, furnitore te ndryshem, etj.

Shoqeria ORTI shpk eshte ne gjendje te paaftesise paguese.

II. Lidhur me mbulimin e kostove te procedurës së falimentimit. Pasuria e nje shoqerie tregtare dhe detyrimet paraqiten ne pasqyrat e saj financiare vjetore. Orti shpk nuk ka dorezuar ne gjykate pasqyra financiare aktuale dhe as te vitit te fundit 2024. Ne ekstraktin historik nuk jane dorezuar pasqyrat financiare qe prej vitit 2016. Me poshte po paraqesim gjendjen financiare ne menyre te permbledhur sipas pasqyrave financiare te vitit 2015 te dorezuara nga shoqeria ne QKB. Keto te dhena nuk jane te njejta per periudhen aktuale por mund te sherbejne si referenca. Në bazë të Pasqyrave Financiare të vitit 2015 (bilanci i fundit vjetor) për ORTI sh.p.k jepen këto të dhëna: aktive totale 1,496,101,744 lekë, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 1,399,994,617 lekë. Shoqëria ka këto pasuri të paluajtshme nr. 9/366, 166/911, 144/21/1, 147/16/1, 135/18, 221/12/1, 131/6, total 17,693 m2 nga të cilat ndërtesë 1,454 m2. Në pasqyrën financiare 2015, toka dhe ndërtesa kanë vlerë 402,497,367 lekë. Konkuldohet se pasuritë e debitorit mund të mbulojnë kostot e procedurave të falimentimit.

III. Lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë së debitorit. ORT sh.p.k eshte me status pasiv ne organet tatimore, pa veprimtari tregtare dhe zoteron vetem pasuri te paluajtshme tokë dhe ndërtesë. Pasuritë e paluajtshme jane nen sekuestro sipas procedurave permbarimore, pra nuk mund te kryhet asnje veprim tregtar per to. Ndertesa eshte e mbyllur dhe nuk ka ruajtje fizike.

IV. Lidhur me marrjen e masave të përkohshme. ORTI shpk është shoqëri me status pasiv ne organet tatimore, pa veprimtari tregtare dhe zoteron vetem pasuri te paluajtshme toke dhe ndertese, te cilat jane me barre hipotekore dhe nen sekuestro permbarimore. Pra, nuk ka rrezik te konsiderueshem qe pronat te tjetersohen. Ne ekstraktin e shoqerise eshte regjistruar administratore e perkohshme Anida Nuri. Keshtu jane kufizuar veprimet e administratorit Kadri Mehalla. Nuk eshte e nevojshme te vendosen masa te perkohshme të tjera për të siguruar pasuritë”.

Pas depozitimit të raportit të administratorit të përkohshëm mbikëqyrës, ortaku i vetëm i shoqërisë ORTI sh.p.k., depozitoi Shkresën datën 2589/1 Prot., datë 29.04.2025 të DRT Elbasan me përmbajtje listëpagesa të periudhës Janar 2016-Janar 2018.

II. Vlerësimi i Gjykatës

Përpara shqyrtimit të çështjes në themel, Gjykata kryesisht verifikoi parakushtet procedurale të juridiksionit, kompetencës lëndore dhe legjitimitimit procedural. Bazuar në nenin 36, 41, 42 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 3 pika 9 dhe 11 të Ligjit nr. 110/2016 “Për falimentimin”, duke qenë se debitori ORTI sh.p.k., ka selinë dhe qendrën kryesore të interesin në qytetin e Elbasanit, çështja përfshihet në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e territoriale të

Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në nenin 3 të ligjit nr. 110/2016 përcaktohet se gjyqtar i falimentit caktohet një nga gjyqtarët e seksionit tregtar të gjykatës përkatëse. Pavarësisht mungesës së ndarjes në seksione, në zbatim të Dekretit të Presidentit të Republikës nr.1501, datë 29.5.1996 “*Për krijimin e seksioneve për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, tregtare e familjare pranë gjykatave të rretheve*”, që është pjesërisht në fuqi ende sot, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është kompetente për shqyrtimin e çështjeve tregtare, sikurse çështja objekt gjykimi.

Falimentimi është procedura ligjore që zbatohet, kur shoqëria tregtare apo personi fizik tregtar nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij. Procedura e falimentimit mund të fillojë ndaj çdo debitori si person fizik ose juridik të së drejtës private, madje edhe pas prishjes së personit juridik që ende nuk është likuiduar. Procedura është gjithashtu e zbatueshme për shoqëritë me kapital publik ose shtetëror, të organizuara si person juridik privat. Por, subjektet publike objekt i së drejtës administrative nuk mund t’i nënshtrohen falimentimit. Instituti i falimentimit përmban disa veçori. *Së pari*, falimentimi ka vend, kur personi juridik apo fizik nuk mund të përmbushë më detyrimet financiare. *Së dyti*, deklarimi i falimentimit kërkon ndërhyrjen e një gjykate civile, seksioni tregtar, të cilës i përcillen dokumente justifikuese. *Së treti*, procesi gjyqësor i falimentimit konsiston në likuidimin e aktiveve të shoqërisë për të rimbursuar debitorët. *Së katërti*, falimentimi sjell pasoja nëpërmjet humbjes së vendeve të punës dhe ka impakt mbi furnizuesit, klientët dhe ekonominë lokale. *Së pesti*, falimentimi mund të sjellë likuidimin gjyqësor ose riorganizimin në perspektivë të sipërmarrjes. *Së gjashti*, nga sa më sipër del se sipërmarrësit duhet të administrojnë aktivitetin e tyre me kujdes dhe të kërkojnë këshilla profesionale me qëllim për të shmangur falimentimin dhe pasojat e dëmshme të tij.

Kjo procedurë kalon në disa etapa: (i) *kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit, që mund të iniciohet nga debitori ose kreditori*; (ii) *Fillimi i procedurës së falimentimit*; (iii) *Mbledhja e raportimit*; (iv) *Riorganizimi dhe kur nuk është e mundur* (v) *Likuidimi*; (vi) *Përfundimi i procedurës së falimentimit*, që finalizohet me prishjen e personit juridik dhe çregjistrimin e tij nga regjistri tregtar. Gjithashtu mund të kërkohej marrja e masave të përkohshme.

Ligjvënësi ka rregulluar në mënyrë të posaçme falimentimin me Ligjit nr. 110/2016 “*Për falimentimin*”. Ky ligj përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për të lehtësuar zgjidhjen dhe shlyerjen kolektive të detyrimeve të debitorit në një procedurë falimentimi. Procedura e falimentimit synon të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit përmes riorganizimit të aktivitetit ose përmes likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes të të ardhurave.

Fillimi i procedurës së falimentimit mund të kërkohej nga debitori ose kreditorët në formë të shkruar dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Debitori paraqet kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit, kur ndodhet në kushtet e (i) *paaftësisë ekzistuese* ose (ii) *paaftësisë paguese në një të ardhme të afërt*. Madje debitori është i detyruar të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurave të falimentimit, brenda 60 ditëve nga data në të cilën dinte ose duhet të dinte që është bërë i paaftë të paguajë. Në rastin e subjekteve juridike, ky detyrim i takon çdo anëtarit të organit drejtues. Nga ana tjetër, kërkesa mund të paraqitet nga kreditori, kur (i) *provon se debitori është në gjendjen e paaftësisë paguese*. Për të paraqitur këtë kërkesë, kreditori duhet të provojë ekzistencën e një detyrimi të maturuar dhe të papaguar. referuar nenit 16/2 të ligjit Gjendja e paaftësisë paguese prezumohet në qoftë se kreditori ka dështuar në ekzekutimin e një detyrimi

në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar, sipas parashikimeve të nenit 517, të Kodit të Procedurës Civile. Kërkesa e paraqitur nga kreditori i njoftohet, debitorit i cili ka të drejtë të kundërshtojë fillimin e procedurës së falimentimit.

Elementet që duhet të përmbajë kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit parashikohen në nenin 14 të ligjit nr. 110/2016. Kjo dispozitë përcakton se "Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit mbështetet në paaftësinë paguese ekzistuese të debitorit ose në paaftësinë paguese në një të ardhme të afërt. Së bashku me kërkesën, debitori paraqet edhe dokumentacionin dhe informacionin në vijim:

a) raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit;

b) ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin;

c) bilancin dhe pasqyrat financiare për tri vitet e fundit të aktivitetit të debitorit. Nëse debitori ka ushtruar veprimtari për një periudhë më të shkurtër kohe, për atë sa kjo periudhë është;

ç) listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë: i) vlerën e çdo pasurie në momentin e blerjes; ii) vlerën aktuale të tregut në rast se këto pasuri kanë qenë objekt i rivlerësimit; iii) vendndodhjen e pasurive; dhe/ose iv) të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe v) nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci, ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së siguruar;

d) listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;

dh) listë të kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve;

e) listë të kreditorëve që janë persona juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, nëse është rasti, si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve;

ë) listë të debitorëve të debitorit, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë; f) listë të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë, si paditës ose i paditur."

Gjykata e falimentimit vendos për fillimin e një procedure falimentimi kur plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 29 i ligjit të posaçëm. Në këtë dispozitë parashikohet se vendimi për fillimin e procedurës së falimentimit përmban:

a) në rastin e një personi fizik, emrin, mbiemrin, atësinë, datën e lindjes, numrin personal të identifikimit dhe vendbanimin e debitorit ose, në rastin e personit juridik, emrin, llojin e veprimtarisë, numrin e identifikimit të personit të tatueshëm dhe vendbanimin;

b) caktimin e administratorit të falimentimit ose administratorit mbikëqyrës në rastet kur gjykata e falimentimit vendos regjimin e specifikuar në pikën 1, të nenit 61, të këtij ligji. Vendimi përmban emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal të identifikimit, numrin e licencës dhe adresën e administratorit të caktuar, duke treguar nëse është një administrator falimentimi ose një administrator mbikëqyrës;

c) urdhrin që siguron botimin e një kopjeje të shkurtuar të vendimit në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Fletoren Zyrtare;

ç) kërkesën ndaj çdo personi ose subjekti që pretendon të jetë kreditor i debitorit, për të paraqitur pretendimet e tij ndaj administratorit të falimentimit ose administratorit mbikëqyrës brenda 45 ditëve nga publikimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

d) datën në të cilën do të mbahet mbledhja mbi raportimin, e cila caktohet jo më vonë se 120

ditë nga data e vendimit;

dh) në rastet kur lista e kreditorëve, që është bashkëlidhur nga debitori në bazë të nenit 14, të këtij ligji, është e disponueshme, gjykata e falimentimit cakton një komitet të përkohshëm të kreditorëve, përveç rastit kur për shkak të veprimtarisë së vogël të biznesit ose faktorëve të tjerë, caktimi i këtij është i papërshtatshëm. Gjykata e falimentimit cakton 3 anëtarë, përfshirë 2 kreditorët më të mëdhenj të pasiguruar dhe kreditorin më të madh të preferuar. Nëse njëra prej kategorive nuk është e disponueshme ose nëse kreditorët refuzojnë t'i bashkohen komitetit të kreditorëve, gjykata e falimentimit cakton shumën vijuese më të madhe për secilën kategori, përveç asaj të kreditorëve fundorë. Në rast të paraqitjes së kërkesës nga kreditori/ët, gjykata e falimentimit cakton një komitet të përkohshëm të kreditorëve nëse debitori ka paraqitur listën e kreditorëve, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji.

Mbështetur në nenin 19 të Ligjit nr.110/2016, meqenëse debitori paraqiti kundërshtimin me shkrim Gjykata vendosi të shqyrtojë çështjen në seancë dëgjimore, ku u thirr pala iniciuese e këtij procesi dhe debitori ORTI sh.p.k.

Gjykata vlerëson se kërkesa është e bazuar në ligj dhe në prova, prandaj duhet të pranohet. Kërkuesi legjitimohet për të paraqitur kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit, pasi provoi se është kreditor i shoqërisë "ORTI" sh.p.k., subjekt që mund të vërë në lëvizje gjykatën për kërkesë të kësaj natyre, në përputhje me nenin 16 të Ligjit nr. 110/2016. Gjithashtu provohet se shoqëria tregtare "ORTI" sh.p.k është në kushtet e paaftësisë paguese. Nga Shkresa nr. 2173/1, datë 08.04.2025 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, rezulton se shoqëria është e regjistruar në statusin pasiv që nga viti 2019, domethënë nuk ushtron veprimtari tregtare që prej kësaj periudhe. Domethënë nuk ka asnjë fitim për më shumë se tre vite. Me Raportin e Administratorit të Përkohshëm të Falimentimit datë 28.04.2025, administratorja e përkohshme Znj. Anida Nuri ka rekomanduar hapjen e procedurës së falimentimit për këtë subjekt. Nga përmbajtja e këtij raporti vërehet se vetëm ndaj dy subjekteve Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe Raiffeisen Bank sh.a., ky subjekt juridik ka detyrime në vlerë përkatësisht 231,151,596 (dyqind e tridhjetë e një milionë e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) ndaj organeve tatimore lekë dhe 4,000,000 (katër milionë) euro për dy kontratat e kredisë me Raiffeisen Bank, ndërkoë që vlera e pasurive të paluajtshme të debitorit nga një vlerësim paraprak janë 402,497,367. Duhet të mbahet parasysh se administratorja e përkohshme nuk ka përfshirë detyrime që burojnë nga kontrata të tjera, për të cilat nuk ka qenë në dijeni, sepse janë paraqitur me vonesë nga administratori i shoqërisë Z. Kadri Mëhalla. Detyrimet ekzistojnë gjithashtu ndaj subjekteve të tjera si OSHEE sh.a për tre kontrata furnizimi me energji elektrike respektivisht me vlerat 1,927,349.50 lekë, 14,284,265.63 lekë dhe 28,816,872.02. Gjithashtu provohet se shoqëria për të cilën kërkohet hapja e procedurës së falimentimit ka detyrime të pashlyera ndaj 40 (dyzet) personave juridikë dhe fizikë të tjerë si Lara Dairy" sh.p.k, Gema Distribution" sh.p.k, Euro Trade Albania, Albanian Distribution Development etj., me detyrime që variojnë deri në shumën 4,000,000 (katër milionë) lekë. Bilancet janë mbajtur nga shoqëria deri në vitin 2015 dhe më tej nuk ka pasqyra financiare. Pra, dukshëm aktivet nuk mbulojnë pasivet e shoqërisë dhe madje kjo procedurë duhet të kishte nisur që para disa vitesh.

Për sa i përket pretendimit se shoqëria është rënduar dhe për rrjedhojë ndodhet në vështirësi financiare për shkak të gjobave dhe bllokimit nga organet tatimore, e cila është ankimuar, vlerësohet i pambështetur. Njoftim vlerësimi tatimor që nxirret në bazë të Ligjit "Për procedurat

tatimore” përbën akt administrativ. Megjithëse është kundërshtuar në rrugë gjyqësore, ky akt administrativ prezumohet i ligjshëm, deri në një vendimmarrje të kundërt nga gjykatat më të larta. Me Vendimin nr. 777, datë 20.03.2024 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit nuk përbën shkak për pezullimin e këtij gjykimi apo për rrëzimin e kërkesës dhe refuzimin e hapjes së procedurës së falimentimit. Dënimi me gjobë si çdo kundërvajtje administrative prezumohet se është nxjerrë në përputhje me ligjin. Çdo interpretim i kundërt do të çënonte më tej interesat e kreditorëve. Ligji nr. 110/2016 ka parashikuar në mënyrë të shprehur rastet se kur pezullohet gjykimi, por parimi bazë i përcaktuar që në nenin 5 të tij se procedura e falimentimit nuk pezullohet ose ndërpritet, përveçse kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë ligj.

Gjatë këtij gjykimi, rezultoi se janë kreditorë dhe që për pasojë kanë të drejtë të jenë të pranishëm në vijim si “palë pjesëmarrëse”, konform nenit 3/22 të Ligjit subjektet pas depozitimit të akteve shtesë nga shoqëria ORTI sh.p.k: konkretisht (41 subjekte): Lara Dairy” sh.p.k, Dilo” sh.p.k, Gema Distribution” sh.p.k, Euro Trade Albania” sh.p.k, Albanian Distribution Developement” sh.p.k., Harri Lena” sh.p.k., “Sea Salt Albania” sh.p.k, “ABC Group” sh.p.k., “FENIS” sh.p.k., person fizik Alban Lika., shoqëria tregtare “Manilla” sh.p.k., “Eugen Skremo” sh.p.k., “German Brands” sh.p.k, “SE& AN” sh.p.k, “BBI Group” sh.p.k, “Brand Distribution” sh.p.k, “Çini 2009” sh.p.k, “Çini 2009” sh.p.k., “KJENDY” sh.p.k., “Raiffeisen Bank” sh.p.k., “Llabunishti” sh.p.k., “HARJA” sh.p.k, “EHW” sh.p.k., “Micro Credit Albania” sh.p.k, “Bloja” sh.a., “PRIMA” sh.p.k., “Pasticeri Lika” sh.p.k, Agjencia Kolektive e Mbrojtjes së të Drejtave Kolektive, “Abdurramani” sh.p.k., Banca Credins” sh.a., “Tona Co” sh.p.k, “Klimart Albania” sh.p.k., Erzeni” sh.p.k., “Orbico” sh.p.k., “Alpha Security” sh.p.k., Banka e Parë e Investimeve” sh.a, Prokuroria pranë GJSHPJP Elbasan, OSHEE Elbasan sh.a dhe organet tatimore të përfaqësuara nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Mbështetur në nenin 29, pika dh) të Ligjit nr. 110/2016 nevojitet ngritja e komisionit të përkohshëm të kreditorëve, i cili mbikëqyr veprimtarinë e administratorit të falimentimit. Çmohet se ky komitet duhet të përbëhet nga 5 anëtarë, pasi ka një numër të konsiderueshëm kreditorësh. Në bazë të ligjit, duhet të ketë në përbërje kreditorin më të madh të preferuar, por duke qenë se nuk ka të tillë sipas raportit paraprak të administratorit, mbeten të caktohen kreditorët e tjerë. Duke pasur parasysh listën e kreditorëve të depozituar nga kërkuesi dhe shumën e tyre respektive të kredive, vlerësohet se në përbërje të këtij komiteti të përkohshëm duhet të përfshihen: (i) Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, (ii) Raiffeisen Bank sh.a., (iii) Euro Trade Albania sh.p.k. (iv) Alpha Security sh.p.k dhe nga (v) lista e punëmarrësve Z. Olsi Ismajli për organizimin e takimit me të cilët ngarkohet administratorja e falimentimit. Në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 110/2016 pas caktimit të komitetit të përkohshëm të kreditorëve, mbledhja e kreditorëve në çdo moment, mund të zëvendësojë ose të caktojë një komitet të ri kreditorësh.

Për sa më sipër, nga shqyrtimi paraprak i akteve dhe raporti i administratorit të përkohshëm vërtetohet gjendja e paafësisë paguese të debitorit ORTI sh.p.k, Prandaj duhet të deklarohet fillimisht i procedurës së falimentimit, duke caktuar administratoren e falimentimit. Mbështetur në nenin 1. i ligjit nr. 110/2016, me qëllim ruajtjen e masës së falimentimit, vlerësohet se duhet pezullohet aktiviteti i debitorit. Gjithashtu duhet të ndalohet çdo veprim ekzekutimi mbi pasuritë e debitorit shoqërisë tregtare “ORTI sh.p.k.

Duke qenë se nuk përbën pengesë ligjore, por edhe me qëllim mbrojtjen e interesave

kreditorëve, debitorëve dhe punëmarrësve të shoqërisë nëpërmjet zhvillimit të një procedure sa më të shpejtë, si administrator i falimentimit do të caktohet i njëjti person fizik, që ka ushtruar detyrën e administratorit të përkohshëm mbikëqyrës Znj. Anida Nuri.

Administratori i falimentimit ngarkohet që të bëjë inventarizimin e të gjitha pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, të përcaktojë masën e falimentimit, listën e kreditorëve sipas kategorive përkatëse ligjore (kreditorë të siguruar, të pasiguruar, preferencialë, kreditorë të procedurës së falimentimit etj) dhe debitorëve në përputhje me aktet nënligjore VKM dhe akte nënligjore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, çdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj, si dhe të paraqesë raporte me shkrim herë pas here, kur çmohet e nevojshme ose sa herë që të kërkohet nga gjykata e falimentimit.

Lidhur me ankim. Kundër vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga e nesërmyja e njoftimit. Megjithatë, referuar nenit 10 të Ligjit nr. 110/2016, ankim nuk pezullon zbatimin e vendimeve apo urdhrave të dhëna nga gjykata e falimentimit, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, bazuar në nenin 125, 309 e 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 12, 14, 17, 22, 23 Ligjit nr. 10/2016 “Për falimentimin”


VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kreditorit shoqërisë tregtare Raiffeisen Bank sh.,a
2. Deklarimin e hapjes sot në datë 14.05.2025, ora 14:49 të procedurës së falimentimit të shoqërisë tregtare “ORTI” sh.p.k., me administrator Z. Kadri Mëhalla, dhe seli në adresën: Bashkia Elbasan, Lagjja 28 Nëntori”, autostrada Elbasan-Metalurgji, Qendra Tregtare Orti, me administrator të përkohshëm mbikëqyrës Znj. Anida Nuri.
3. Emërimin si administratore të falimentimit për shoqërinë “ORTI” sh.p.k, të Znj. Anida Nuri, me adresë: Bashkia Tiranë, Rr “Babe Rexha”, P.10/1, Shk.2 Ap 27, Cel +355694059730.
4. Pezullimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare “ORTI” sh.p.k.
5. Ndalohej çdo veprim ekzekutimi mbi pasurinë e debitorit shoqërisë tregtare “ORTI” sh.p.k.
6. Të gjithë kreditorët e shoqërisë tregtare “ORTI” sh.p.k kanë të drejtë të paraqesin pranë administratores së falimentit pretendimet e tyre brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga publikimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
7. Caktimin e komitetit të përkohshëm të kreditorëve të përbërë nga 5 (pesë) anëtare dhe konkretisht: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, Raiffeisen Bank sh.a., Euro Trade Albania sh.p.k., Alpha Security sh.p.k dhe nga lista e punëmarrësve Z. Olsi Ismajli për organizimin e takimit me të cilët ngarkohet administratorja e falimentimit Anida Nuri.
8. Mbledhja mbi raportimin do të zhvillohet **pas 90 ditëve**, në datën **14.11.2025, ora 12:00**
9. Të gjithë kreditorët e shoqërisë tregtare “ORTI” sh.p.k., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

10. Personat qe kane detyrime ndaj debitorit shoqërisë tregtare "ORTI" sh.p.k., t'ia paguajne dhe shlyejne ato administratores se falimentimit Znj. Anida Nuri.
11. Mbledhja e kreditorëve te shoqërisë "ORTI" sh.a., për verifikim të mbahet brenda 60 (gjashtëdhjetë) diteve nga perfundimi i afatit te depozitimit te pretendimeve.
12. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe është menjëherë i ekzekutueshëm.
13. Urdhërohet publikimi i vendimit të shkurtuar per hapjen e procedurave te falimentimit te Shoqërisë "ORTI" sh.p.k. në Fletoren Zyrtare.
14. Nje kopje e vendimit per hapjen e procedurave te falimentimit te Shoqërisë "ORTI" sh.p.k., t'i njoftohet administratores se falimentimit te Shoqërisë "ORTI" sh.p.k. Znj. Anida Nuri.
15. Nje kopje e vendimit per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqërisë "ORTI" sh.p.k., t'i dërgohet Qendres Kombetare te Biznesit.
16. Një kopje e shkurtimit të këtij vendimi të afishohet publikisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si dhe në faqen e internetit të kësaj gjykate
17. Nje kopje e vendimit për hapjen e procedurave te falimentimit te Shoqërisë "ORTI" sh.p.k., t'i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme, me qellim njoftimin e te gjitha Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe kryerjen e veprimeve konform Ligjit nr. 110/2016 "Për falimentimin".
18. Nje kopje e vendimit per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqërisë "ORTI" sh.p.k., t'i dërgohet te gjitha bankave te nivelit te dyte te Republikën e Shqiperise.
19. Një kopje e vendimit per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqërisë "ORTI" sh.p.k., t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme te Tatimeve.
20. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave te falimentimit te shoqërisë "ORTI sh.p.k sh.a., t'i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Falimentimit pranë Ministrise se Drejtësisë.
21. Një kopje e vendimit per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqërisë "ORTI" sh.p.k., t'i dërgohet Dhomes Kombetare te Noterëve.
22. Urdhërohet publikimi dy here i vendimit, te shkurtuar, per hapjen e procedurave te falimentimit te shoqërisë tregtare "ORTI" sh.p.k., në gazetën "Panorama" dhe Gazeta "Shekulli".
23. Një kopje e këtij vendimi t'u njoftohet kreditorëve sipas listës së paraqitur nga debitori në prapësimet me shkrim.
24. Në zbatim të nenit 29, paragrafi 4 administratori ngarkohet me dërgimin e një kopje të përmbledhur të vendimit secilit prej kreditorëve të njohur të debitorit, pavarësisht nga fakti që kreditorët dhe çdo palë tjetër e interesuar konsiderohen të njoftuar si pasojë e shpalljes publike.
25. Shpenzi
26. Kundër l
brenda 1:

**U shpall sot në l
SEKRETARE**

ERISA ÇILI




RTI sh.p.k.

in e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm,
nja e njoftimit të tij.

GJYQTAR

ARDIT KUKA

